



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 24.07.2023)*

**Pika 1 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

1.1 “Për një ndryshim në vendimin nr. 157, datë 20.04.2022 “Për miratimin e strukturës organizative të administratës së Këshillit të Lartë Gjyqësor” i ndryshuar”.

1.2 “Për miratimin e strukturës dhe nivelit të pagave për administratën gjyqësore”.

*Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.*

*Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:12 dhe mbaroi në orën 11:38.*

Në mbledhje ishin të pranishëm nëpërmjet platformës\* dhe në sallë:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Ilir Rusi* (zëvendëskryetar)\*
3. *Klodian Kurushi* (anëtar)
4. *Fatmira Luli* (anëtare)
5. *Irena Plaku* (anëtare)
6. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
7. *Ridvan Hado* (anëtar)
8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Marçela Shehu* (anëtare)\*

*10. Brikena Ukperaj (anëtare)*

*11. Yllka Rupa (anëtare)\**

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

*1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*

*2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*

*3. Etrita Petriti, Drejtore e Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative.*

*4. Xhevdet Haxhiu, Drejtor i Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.*

*5. Kelment Greca, Drejtor i Departamentit të Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit.*

*6. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*

*7. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.*

*8. Valbona Bala, Eksperte (EWMI-INL).*

*9. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*

#### **RENDI I DITËS:**

1. Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

1.1 “Për një ndryshim në vendimin nr. 157, datë 20.04.2022 “Për miratimin e strukturës organizative të administratës së Këshillit të Lartë Gjyqësor” i ndryshuar”.

1.2 “Për miratimin e strukturës dhe nivelit të pagave për administratën gjyqësore”.

*Naureda Llagami: Përsëritje!*

Po fillojmë mbledhjen e radhës të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datës 24 korrik.

Siç jeni në dijeni, nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor kërkohet vendimmarrje për rreth 12 çështje.

Pa humbur kohë po fillojmë me aktin e parë, i cili ka të bëjë me shqyrtimin e dy projektvendimeve që janë përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, që kanë lidhje me miratimin e strukturës organizative të administratës së Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe miratimin e strukturës dhe nivelit të pagave për administratën gjyqësore. Të dy projekt-aktet vijnë si rezultat i ndryshimeve që janë bërë, kategorizimet e pagës nga vendimi i Këshillit të Ministrave.

Për më shumë detaje, fjalën po ia jap Drejtoreshës së Departamentit të Burimeve Njerëzore, znj. Etrita, e cila do na shpjegojë shkurtimisht qëllimin e këtyre dy projekt-akteve.

***Etrita Petriti:*** Të nderuar!

Referuar VKM-së nr. 325, datë 31.05.2023 “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesa të tjera mbi pagë të Zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, Prefektit, Nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”, VKM e cila ka shfuqizuar VKM-në numër 187, ka lindur detyrimi ligjor për të pasqyruar dhe reflektuar në strukturën aktuale të KLGJ-së dhe në gjykatat e të gjitha niveleve ndryshimet të cilat pasqyrohen në emërtesën, në terminologjinë e kategorisë së pagës, në klasën e pagës.

Kemi pasqyruar strukturën aktuale të KLGJ-së me kategoritë e pagave dhe përkrah klasat e pagave referuar VKM-së së cituara nr. 325.

Gjithashtu, referuar gjykatave në të gjitha nivelet, sipas vendimit të KLGJ-së për kategorizimin e tyre, kemi pasqyruar nivelet e pagave sipas lidhjes së parë Gjykata e Lartë, të cilat janë të specifikuara në VKM-në nr. 325, kategorinë e parë të gjykatave me klasat përkatëse dhe referuar edhe lidhjeve në VKM-në nr. 325, kategorinë e dytë të mesme të gjykatave dhe kategorinë e tretë të ulët të gjykatave, referuar klasave të pasqyruara në VKM-në nr. 325.

Pra detyrimi ligjor i KLGJ-së është pasqyrimi i klasave të reja të pagave dhe referuar edhe grupit të diplomës të pasqyruara në draftin e paraqitur përpara Këshillit.

***Naureda Llagami:*** Ftoj kolegët nëse kemi ndonjë pyetje?

Nëse jo, atëherë kalojmë me projekt-aktin e parë, që është ndryshimi i vendimit nr. 157, që relatoi drejtoresha. Kalojmë në votim, Ilir!

**Ilir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Naureda Llagami:** Marçela!

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Naureda Llagami:** Yllka!

**Yllka Rupa:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Në vendimin nr. 157, datë 20.04.2022 “Për një ndryshim në vendimin nr. 12, datë 18.01.2019 “Për miratimin e strukturës organizative të administratës së Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i ndryshuar, bëhet ndryshim në klasat e pagave në strukturën organizative të administratës, i cili është pasqyruar në strukturën organizative, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm, Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative, Departamenti i Programimit dhe Monitorimit të Buxhetit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**Naureda Llagami:** Kalojmë tek projekt-akti tjetër që ka të bëjë me miratimin e strukturës dhe nivelit të pagave për administratën gjyqësore.

**Etrita Petriti:** Referuar vendimit nr. 147 të Këshillit të Lartë Gjyqësor mbi kategorizimin e gjykatave si dhe referuar VKM-së nr. 325, datë 31.05.2023 kemi pasqyruar sipas lidhjeve që kanë të pasqyruar klasat e pagave dhe grupin e diplomës në lidhje specifike të VKM-së nr. 325: kategoria e parë e lartë ku përfshihen disa gjykata sipas lidhjes nr. 2 ku janë pasqyruar klasat e pagave, grupin e diplomës; kategoria e dytë e mesme të gjykatave kemi pasqyruar klasat e pagave dhe grupin e diplomës; gjithashtu edhe në kategorinë e tretë të ulët të gjykatave, referuar lidhjeve të pasqyruara të VKM-së nr. 325. Pra kemi ndryshimin e terminologjisë nga kategoria e pagës në klasat e pagës.

**Naureda Llagami:** Sa përfiton administrata me këtë rritjen e kategorisë? Kemi përfitim të pagesës?

**Etrita Petriti:** Po! Kemi shtesa në pagesë.

**Naureda Llagami:** Kemi shtesa për të gjithë kategoritë e pozicioneve.

Ndonjë pyetje?

(Nuk ka pyetje.)

Atëherë, nëse nuk kemi diskutime, kalojmë në miratimin e projekt-aktit. Ilir!

**Ilir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e strukturës dhe nivelit të pagave për administratën gjyqësore:

a) Për Gjykatën e Lartë sipas Lidhjes nr. 1, bashkëlidhur dhe pjesë e këtij vendimi;

b) Për gjykatat e kategorisë së parë (e lartë) sipas Lidhjes nr. 2, bashkëlidhur dhe pjesë e këtij vendimi;

c) Për gjykatat e kategorisë së dytë (e mesme) sipas Lidhjes nr. 3, bashkëlidhur dhe pjesë e këtij vendimi;

d) Për gjykatat e kategorisë së tretë (e ulët) sipas Lidhjes nr. 4, bashkëlidhur dhe pjesë e këtij vendimi.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm, Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative, Departamenti i Programimit dhe Monitorimit të Buxhetit dhe gjykatat e të gjitha niveleve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 1 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 24.07.2023)*

**Pika 2 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e formularëve standard të regjistrimit elektronik të organizatave jofitimprurëse”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:12 dhe mbaroi në orën 11:38.***

Në mbledhje ishin të pranishëm nëpërmjet platformës\* dhe në sallë:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)\*
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Irena Plaku*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Marçela Shehu*** (anëtare)\*
10. ***Brikena Ukperaj*** (anëtare)
11. ***Yllka Rupa*** (anëtare)\*

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Etrita Petriti, Drejtore e Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative.*
- 4. Xhevdet Haxhiu, Drejtor i Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.*
- 5. Kelment Greca, Drejtor i Departamentit të Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit.*
- 6. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 7. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.*
- 8. Valbona Bala, Eksperte (EWMI-INL).*
- 9. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*

#### **RENDI I DITËS:**

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e formularëve standard të regjistrimit elektronik të organizatave jofitimprurëse”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

*Naureda Llagami:* Kalojmë tashmë tek akti tjetër që ka të bëjë me miratimin e formularëve standard të regjistrimit elektronik të organizatave jofitimprurëse. Siç jeni në dijeni, nga ana e Këshillit janë marrë masa për ngritjen e një regjistri elektronik për të cilin ne kemi thënë që është detyrim që ky regjistër të jetë në funksion deri në fund të vitit 2023. Një nga detyrimet që ka ligji për organizatat jofitimprurëse është edhe detyrimi për formularët standard të regjistrimit elektronik. Këto formularë janë bërë me një grup pune pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, ku kanë qenë pjesëmarrës Gjykata e Shkallës së Parë e cila është edhe gjykata përgjegjëse për administrimin e këtij regjistri, e cila ka dhënë



edhe të gjithë komentet. Duke qenë se është një regjistër për organizatat jofitimprurëse, është përcjellë për mendim të gjithë organizatave jofitimprurëse, me qëllim që nëse edhe ato kishin ndonjë shqetësim apo merak, të mund ta adresonin.

Me thënë të vërtetën nuk kanë sjellë asnjë koment nga organizatat jofitimprurëse, kështu që duke dashur që të respektojmë afatet ligjore për hartimin e këtyre formularëve, e prezantojmë sot në mbledhjen e KLGJ-së.

Në mënyrë më të detajuar, ia jap fjalën z. Greca, i cili është edhe drejtori i administrimit të gjykatave pranë KLGJ-së.

***Kelment Greca:*** Përshëndetje të nderuar anëtarë!

Po përmbledh pikat kryesore të projekt-aktit.

Ligji nr. 80/2021 përcakton procedurat e regjistrimit dhe mbajtjes së regjistrit të organizatave jofitimprurëse, të cilat kanë detyrimin e regjistrimit sipas legjislacionit në fuqi. Neni 4 i ligjit ngarkon Këshillin e Lartë Gjyqësor të caktojë me vendim datën e fillimit të funksionimit të regjistrit (që është bërë kjo me vendimin nr. 35, datë 26.01.2022, për funksionimin e regjistrimit në datën 30 dhjetor 2023).

Gjithashtu, neni 52 pika 2, ngarkon Këshillin të miratojë formularët standard të regjistrit elektronik, më konkretisht:

- Neni 6, pika 2, parashikon formularin e kërkesës për regjistrim;
- Neni 28, pika 3, parashikon konfirmimin e kërkesës për regjistrim;
- Neni 29, pika 1, parashikon formularin e njoftimit të pezullimit të kërkesës për regjistrim;
- Neni 41, përcakton se Këshilli i Lartë Gjyqësor me propozimin e kancelarit të Gjykatës, miraton formatet dhe përmbajtjen e certifikatave;
- Neni 44, pika 3, parashikon miratimin nga Këshilli të formateve të ekstrakteve dhe kërkesës për lëshimin e tyre.

Në zbatim të këtyre dispozitave, në KLGJ pjesë e grupit të punës ka qenë kancelari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë si propozues i dy pikave që sapo përmenda më lart.

Është përgatitur një vendim me 9 formularë standard:

Shtojca nr. 1. parashikon të dhënat e kërkesës fillestare (me 5 ndarje).

Shtojca nr. 1.1 përcakton dokumentet që shoqërojnë kërkesën, në rastet kur organizata jofitimprurëse është shoqatë, fondacion, qendër ose degë e OJF-së së huaj, listë kjo që mban në vëmendje specifikat për secilën tipologji organizate.

Shtojca nr. 2 është konfirmimi i kërkesës për regjistrim.

Shtojca nr. 3 parashikon formularin standard mbi njoftimin e pezullimit, arsyet që parashikon ligji.

Shtojca nr. 4 parashikon formularin e aplikimit për ndryshimin e të dhënave të regjistrimit.

Shtojca nr. 5 parashikon strukturën dhe përmbajtjen e certifikatës së regjistrimit të OJF.

Shtojca nr. 6 është formati i Buletinit të OJF-ve.

Shtojca nr. 7 është formati i aplikimit për ekstraktin e OJF.

Shtojca nr. 8 parashikon formatin standard të ekstraktit historik.

Me qëllim vijimin e punës i jemi drejtuar organizatave jofitimprurëse. Nuk kemi marrë fedback (feedback) prej tyre.

Ndaj ju prezantojmë formularët standard të cilët do të jenë fizikisht të gatshme për regjistrin elektronik të organizatave jofitimprurëse. Regjistri është krijuar, vetëm presim që të jetë funksional dhe të hedhim të gjitha të dhënat deri më 30 dhjetor 2023.

Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit!

Nëse kemi ndonjë pyetje nga kolegët?

*(Nuk ka pyetje.)*

Nëse jo, atëherë kalojmë në miratimin e projekt-aktit sipas propozimit të ardhur.

Ilir!

**Ilir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

*Marçela Shehu*: Dakord.

*Yllka Rupa*: Pro.

*Brikena Ukperaj*: Pro.

*Klodian Kurushi*: Dakord.

*Naureda Llagami*: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e formularëve standard të regjistrit elektronik të organizatave jofitimprurëse, sipas shtojcave bashkëlidhur, pjesë përbërëse të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

\* \* \*

(Pika 2 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 24.07.2023)*

**Pika 3 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi shpërndarjen e aktiveve (pajisjeve elektronike dhe aseteve të ndryshme software), në gjykatat e të tre niveleve”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:12 dhe mbaroi në orën 11:38.***

Në mbledhje ishin të pranishëm nëpërmjet platformës\* dhe në sallë:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)\*
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Irena Plaku*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Marçela Shehu*** (anëtare)\*
10. ***Brikena Ukperaj*** (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jasthë.*
- 3. Etrita Petriti, Drejtore e Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative.*
- 4. Xhevdet Haxhiu, Drejtor i Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.*
- 5. Kelment Greca, Drejtor i Departamentit të Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit.*
- 6. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 7. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.*
- 8. Valbona Bala, Eksperte (EWMI-INL).*
- 9. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*

**RENDI I DITËS:**

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi shpërndarjen e aktiveve (pajisjeve elektronike dhe aseteve të ndryshme software), në gjykatat e të tre niveleve”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

*Naureda Llagami:* Kalojmë ne projekt-aktin e radhës që ka të bëjë me shpërndarjen e aktiveve (pajisjeve elektronike dhe aseteve të ndryshme software), në gjykatat e të tre niveleve.

Për më shumë detaje fjalën ia jap drejtorit të buxhetit, z. Xhevdet.

*Xhevdet Haxhiu:* Faleminderit Kryetare!

Të nderuar anëtarë!

Departamenti i Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit, në cilësinë e strukturës përgjegjëse për administrimin e pajisjeve dhe sistemeve të IT në KLGJ dhe gjykatat e të gjitha niveleve, përgatiti një memo në datën 13.07.2023, referuar VKM nr.495, datë 21.07.2022, “Për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave”, duke kërkuar shpërndarjen e aktiveve (pajisjeve elektronike dhe aseteve të ndryshme software), të cilat janë blerë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor për nevojat e paraqitura nga gjykatat e të gjitha niveleve, gjatë viteve buxhetore 2022 dhe 2023, me qëllim plotësimin e nevojave të tyre për pajisje të teknologjisë e asete software dhe të kryerjes së zhvillimeve informatike në sistemin e menaxhimit të çështjeve gjyqësore, si dhe digjitalizimit të arkivave të gjykatave.

Kështu gjatë vitit buxhetor 2022, u realizuan, blerje programe software, zhvillime të reja, migrim të dhënash të sistemit të menaxhimit të çështjeve dhe pajisje, blerje mallra dhe pajisje IT për programin e digjitalizimit të arkivave të gjykatave dhe blerje mallra dhe pajisje IT mbi implementimin e regjistrit elektronik të OJF-ve, sipas pasqyrës nr. 1, pasqyrës nr. 2 dhe pasqyrës nr. 3, bashkëlidhur këtij relacioni.

Ndërsa gjatë vitit 2023, nga KLGJ u realizuan blerje pajisje audio vizuale, F-V dhe blerje të pajisjeve elektronike / kompjuterike, sipas pasqyrës nr. 4 dhe pasqyrës nr. 5, bashkëlidhur.

Për sa më sipër, Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, i propozon seancës plenare të Këshillit, shqyrtimin dhe miratimin e relacionit mbi shpërndarjen e aktiveve në gjykatat e të gjitha nivele, sipas pasqyrave nr. 1 – nr. 5, bashkëlidhur këtij relacioni.

Duke ju falënderuar!

Në pritje të ndonjë pyetjeje të mundshme.

**Naureda Llagami:** Faleminderit!

Kemi ndonjë diskutim nga kolegët?

*(Nuk ka diskutime.)*

Nëse jo, atëherë kalojmë në votimin e projekt-aktit sipas propozimit. Ilir!

**Ilir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Pro.

*Dritan Hallunaj*: Pro.

*Ridvan Hado*: Dakord.

*Alban Toro*: Dakord.

*Fatmira Luli*: Dakord.

*Marçela Shehu*: Dakord.

*Yllka Rupa*: Pro.

*Brikena Ukperaj*: Pro.

*Klodian Kurushi*: Dakord.

*Naureda Llagami*: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e shpërndarjes së aktiveve (pajisjeve elektronike dhe aseteve të ndryshme software), në gjykatat e të tre niveleve, sipas pasqyrave nr. 1 – nr. 5, bashkëlidhur dhe pjesë e këtij vendimi.

2. Me zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 3 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 24.07.2023)*

**Pika 4 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi ndryshimin e destinacionit dhe transferimin e fondeve në programin 03310, shpenzime kapitale, për vitin buxhetor 2023”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik Administrimit dhe Buxhetit.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:12 dhe mbaroi në orën 11:38.***

Në mbledhje ishin të pranishëm nëpërmjet platformës\* dhe në sallë:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)\*
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Irena Plaku*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Marçela Shehu*** (anëtare)\*
10. ***Brikena Ukperaj*** (anëtare)



Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jasthë.*
- 3. Etrita Petriti, Drejtore e Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative.*
- 4. Xhevdet Haxhiu, Drejtor i Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.*
- 5. Kelment Greca, Drejtor i Departamentit të Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit.*
- 6. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 7. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.*
- 8. Valbona Bala, Eksperte (EWMI-INL).*
- 9. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*

**RENDI I DITËS:**

4. Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi ndryshimin e destinacionit dhe transferimin e fondeve në programin 03310, shpenzime kapitale, për vitin buxhetor 2023”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik Administrimit dhe Buxhetit.

*Naureda Llagami:* Kalojmë tek projekt-akti tjetër që ka të bëjë me ndryshimin e destinacionit dhe transferimin e fondeve në programin 03310, shpenzime kapitale, për vitin buxhetor 2023. Ky projekt-akt do të prezantohet nga të dy drejtorët, sepse ka të bëjë me të dy drejtoritë. Drejtoria përgjegjëse është Drejtoria e Administrimit të Gjykatave e cila do të na japë edhe shpjegime pse duhet të kemi këtë ndryshim destinacioni për këtë fond investimi.

***Kelment Greca: Përshëndetje!***

Në zbatim të legjislacionit për menaxhimin buxhetor, struktura përgjegjëse për administrimin e gjykatave, në kuadër të përmirësimit të sigurisë në gjykata, gjatë vitit 2022, gjatë të dy fazave të përgatitjes së PBA 23-25, ka propozuar implementimin e Projektit të sigurisë në gjykata, me kosto financiare të parashikuar në vlerën 446.000.000 (katërqind e dyzet e gjashtë milion) lekë me t.v.sh., duke përfshirë implementimin e këtij projekti në 10 (14 godina), gjykata të mëdha të sistemit gjyqësor, si dhe duke e shtrirë realizimin e këtij projekti në dy vite buxhetore, në vitin 2023 dhe 2024, përkatësisht nga 223.000.000 (dyqind e njëzet e tre milion) lekë, për secilin vit buxhetor.

Projekti parashikon të nisë për 10 (14 godina), gjykata të mëdha të sistemit gjyqësor, si më poshtë:

1. Gjykata Lartë;
2. Gjykata e Juridiksionit të Përgjithshëm të Apelit;
3. Gjykata Administrative e Apelit;
4. Gjykata Posaçme KKO (fizikisht janë në një godinë);
5. Gjykata e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë (2 godina);
6. Gjykata Administrative Tiranë;
7. Gjykata e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës (dy godina);
8. Gjykata e Juridiksionit të Përgjithshëm, Elbasan;
9. Gjykata e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër (dy godina);
10. Gjykata e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë (dy godina).

Pas miratimit të buxhetit të shtetit me ligjin nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimin nr. 560, datë 29.12.2022 “Për detajimin e buxhetit vjetor 2023, për sistemin gjyqësor”, ka miratuar detajimin e fondeve, ndër të cilat për Projektin e sigurisë në gjykata, u miratua fondi në vlerën 173.000.000 lekë (afërsisht), për t’u realizuar në vitin 2023.

Më pas struktura përgjegjëse për administrimin e prokurimeve në KLGJ, i ka përfshirë në regjistrin e parashikimit të prokurimeve publike për vitin 2023, duke ndjekur të gjitha procedurat e parashikuar në legjislacionin e prokurimit publik.

Në pamundësi për të pasur një projekt, kjo drejtori ka prokuruar edhe studion inxhinierike për prodhimin e projektit. Kompania kontraktuar, referuar detyrave të

marra përsipër për hartimin e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm për zhvillimin e procedurës, (midis të tjerash edhe specifikimeve teknike), vizitoi dhe vlerësoi në çdo gjykatë duke përfshirë identifikimin e rrezikshmërive të mundshme, vlerësimin e infrastrukturës së gjykatave dhe infrastrukturës së tanishme të sigurisë.

Pas analizave, u përgatit një projekt. Ky projekt kishte të përfshirë edhe hartimin e specifikimeve, hartimin e një buxheti (preventivi) bazuar në projekt dhe hartimin e një kalendari të implementimit të detajuar. Në përfundim të punës shoqëria e projektimit dorëzoi pranë KLGJ projekt-preventivin.

Projekt-preventivi u përdorën si dokument standard në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje pajisje për sigurinë në gjykata F-V”, viti buxhetor 2023”, e cila u publikua më datë 15.05.

Pas marrjes së një ankese nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, Komisioni i ngritur për të parë vlerësimin e ankesës, konstatoi se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime dhe mangësi të rëndësishme të cilat vinin nga projekti dhe specifikimet teknike.

Referuar nenit 98, pika 1/c) Ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, është propozuar anulimi, sepse dokumentet e tenderit përmbajnë gabime thelbësore, të cilat duhet të korrigjohen. Të njëjtën gjë ka vendosur edhe Komisioni i Prokurimit Publik, për arsye se ligji detyron që ankesa të shkojë edhe në Komisionin e Prokurimit Publik por edhe në autoritet.

Menjëherë, është komunikuar në rrugë elektronike dhe zyrtare me shkresën përkatëse, me kompaninë e kontraktuar, mbi ndryshimin, qartësimin, korrigjimin e mangësive, argumentimin teknik dhe ligjor të specifikimeve teknike, kriterëve teknike.

Aktualisht KLGJ vijon komunikimet dhe bashkëpunimin me kompaninë e cila nuk ka paraqitur ende një material final për aq sa kërkohet dhe vlerësohet.

Konsultimi me ekspertë dhe prezantimin e situatës aktuale, përcaktimin e qëllimeve të projektit, analizën e risqeve, si dhe identifikimin dhe vlerësimin e zgjidhjeve të mundshme, vlerësohet se është një kohë e pamjaftueshme për gjetjen e zgjidhjeve më të mira për projektin sigurisë së gjykatave. Bashkëpunimi nga KLGJ, ka qenë i pandërprerë për grupin e projektuesve, që kërkon kohë.

Për të realizuar projektin, duhet gjithashtu kohë e nevojshme për nisjen dhe

zhvillimin e procedurës së prokurimit. Ky proces përfshin përgatitjen e DST, vlerësimin e ofertave, lidhjen e kontratës.

Pas prokurimit, nis faza e implementimit. Kjo përfshin instalimin e pajisjeve, konfigurimin e sistemeve, trajnimin e personelit dhe testimin e funksionalitetit të projektit. Ky proces do të kërkojë kohë për të siguruar që gjithçka të jetë funksionale dhe operon siç duhet.

Në një projekt preventiv të konsultuar nga kompania që po përgatit projektin, kostoja totale e projektit për 10 (gjkata); (14 godina) shkon tek 4 miliard lekë pa t.v.sh., vlerë e cila nuk është e njëjtë me vlerën e parashikuar nga struktura përgjegjëse gjatë fazës së përgatitjes së PBA-së dhe fazës së programimit të buxhetit të vitit 2023.

Në kushtet kur ndodhemi në pamundësi të përdorimit të fondeve buxhetore të parashikuara për këtë projekt në vitin 2023, me qëllimin për të mos i djegur këto fonde propozohet miratimi i ndryshimit të destinacionit të fondeve të projektit të sigurisë së gjykatave me qëllim realizimin e projektit për regjistrimin video të sallave të gjyqit RDAV, për gjykatat e të gjitha niveleve, për të gjitha sallat e gjyqit dhe projekti i sigurisë së gjykatave të shtyhet për vitet pasardhës.

Projekti për regjistrimin video të sallave të gjyqit siguron dokumentim të proceseve gjyqësore, përmirëson transparencën dhe llogaridhënien në gjykim, ofron prova të besueshme për rishikime të mëtejshme, etj. Përdorimi i sistemit RDAV i seancave gjyqësore do të mundësojë dokumentim më të saktë të asaj çka ndodh në një seancë gjyqësore duke ofruar mekanizmat që ndihmojnë në monitorimin më të mirë të seancave gjyqësore në kuadër të etikës gjyqësore apo solemnitetit gjatë zhvillimit të tyre. Ky projekt ka për qëllim të përmirësojë transparencën e proceseve gjyqësore dhe të vendimmarrjes. Regjistrimi video i sallave të gjyqit do të ofrojë një dokumentim të saktë dhe të verifikueshëm të proceseve gjyqësore dhe do të ndihmojë në rritjen e besimit të publikut në sistemin ligjor.

Sistemi RDAV do të realizojë regjistrimit vizual me anë të kamerave dhe integritet të tyre me sistemin audio.

Do të sigurohet një ambient më i sigurt për gjyqtarët, avokatët, dëshmitarët dhe personelin tjetër që ndodhet në gjykatë. Do të ndihmojë në identifikimin dhe dokumentimin e rasteve të dhunës, të kërcënimeve ose incidenteve të tjera të sigurisë.

Do të sigurohet një mënyrë efikase për ruajtjen e provave të gjyqit dhe dokumentacionit të rëndësishëm. Regjistrimi video do të ofrojë një burim të qëndrueshëm dhe të besueshëm të informacionit të regjistruar gjatë proceseve gjyqësore.

Do të përmirësohet cilësia e imazheve dhe audios që regjistrohen në sallat e gjyqit.

Do të ofrojë një mënyrë të lehtë për palët në proceset gjyqësore të aksesojnë regjistrimet e sallave të gjyqit.

Sistemi do të evidentojë në mënyrë vizuale dhe sjelljet e palëve ndërgjyqës, gjyqtarit/trupës gjykuese, prokurorit/paditësit, avokatëve/të paditurit, dëshmitarit etj., duke i sinkronizuar këto pamje me zërin e tyre.

Sistemi do të ndihmojë sekretarin gjyqësor i/e të evidentojë më lehtë personat që janë duke folur në fazën e transkriptimit të seancës gjyqësore dhe shmang konfuzionin në lidhje me identifikimin e personit që po flet gjatë seancës gjyqësore.

Ridëgjimi i seancave gjyqësore krijon lehtësi në punë për gjyqtarët në dëgjimin e tyre pasi ofron mundësi vizualizimi dhe sinkronizimi të zërit me pamjet e regjistruara.

Kam radhatur edhe shumë benefite të tjera që sjell ky sistem.

Në fund fare kërkohet nga ky Këshill miratimi i ndryshimit të destinacionit. Xhoda mund ta shpjegojë më shumë këtë pjesë.

***Xhevdet Haxhiu:*** Faleminderit!

Në një miratim të mundshëm të ndryshimit të destinacionit të miratuar nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor në mbledhjen e dhjetorit për përdorimin e këtyre fondeve për projektin e sigurisë së gjykatave dhe miratimin e kalimit të destinacionit të përdorimit të këtyre fondeve për projektin e regjistrimit të videove të sallave të gjyqit (RDAV), sjell pashmangshmërisht pastaj miratimin e shpërndarjes së këtyre fondeve sipas destinacionit për menaxhimin buxhetor duke rishpërndarë fondet në shpenzime kapitale nga kodi i projektit për blerje pajisje zyre, dhe duke shtuar fondet në kodin e projektit për blerje pajisje elektronike në shumën e sipërcituar.

Faleminderit!

***Naureda Llagami:*** Atëherë, fjalën ia jap kolegëve, nëse kanë ndonjë diskutim.

*(Nuk ka diskutime.)*

Nëse jo, kalojmë në votimin e projekt-aktit. Ilir!

**Ilir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Naureda Llagami:** Marçela!

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e ndryshimit të destinacionit të fondeve buxhetore të miratuara për realizimin e Projektit të sigurisë së gjykatave, me destinacion realizimin e Projektit për regjistrimin video të sallave të gjyqit (RDAV), në gjykatat, në shumën 173.100.000 lekë.

2. Miratimin e rishpërndarjes (transferimin) së fondeve në programin 03310, shpenzime kapitale, duke pakësuar fondet në kodin e projektit 18AD801 (blerje pajisje zyre), në shumën 173.100.000 lekë dhe shtuar fondet në kodin e projektit 21AC401 (blerje pajisje elektronike), në shumën 173.100.000 lekë.

3. Me zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 4 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 24.07.2023)*

**Pika 5 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.14, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:12 dhe mbaroi në orën 11:38.***

Në mbledhje ishin të pranishëm nëpërmjet platformës\* dhe në sallë:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Illir Rusi*** (zëvendëskryetar)\*
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Irena Plaku*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Marçela Shehu*** (anëtare)\*

**10. Brikena Ukperaj** (anëtare)

**11. Yllka Rupa** (anëtare)\*

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

**1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**

**2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**

**3. Etrita Petriti, Drejtore e Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative.**

**4. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**

**5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.**

**6. Valbona Bala, Eksperte (EWMI-INL).**

**7. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**

#### **RENDI I DITËS:**

5. Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.14, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

**Naureda Llagami:** Kalojmë tek projekt-akti i radhës që ka të bëjë me kualifikimin e kandidatës {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele. Për më shumë detaje, fjalën ia jap zotit Toro.

**Alban Toro:** Faleminderit!

Pra siç jemi dakordësuar në mbledhjen e datës 17, kjo procedurë verifikimi e kryer për pozicionin 14 do të jetë e vlefshme edhe për pozicionin 15, datë 18.01.2023.



Këshilli i Lartë Gjyqësor kohët e fundit ka filluar procedurat e lëvizjes paralele për të plotësuar vendet vakante në gjykatat e rrethit gjyqësor Tiranë dhe Durrës.

Aktualisht për pozicionin 14 dhe 15 kandidatë është edhe zonja {...} e cila është gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.

Ndërkohë që me vendimin nr. 374, datë 13.07.2023ka filluar procedura e verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Durrës, të shpallura me vendimet nr. 14, nr. 19 dhe nr. 24, datë 18.01.2023, etj. Ndërkohë me cilësinë e relatorit kam administruar aktet të cilat do të provojnë plotësimin e kriterëve formale të kësaj gjyqtareje, të cilat do të mundësojnë më pas vijimin dhe kualifikimin e mëtejshëm.

Në këtë aspekt, është parë përvoja profesionale minimale për lëvizjen për të cilën është një nga kriteret që kërkohet për lëvizjen paralele.

Në lidhje me plotësimin e këtij kriteri është marrë në konsideratë që kandidatja duhet të ketë të paktën 1 vit përvojë profesionale si gjyqtare në fushën e të drejtës civile gjatë 5 viteve të fundit përpara kandidimit. Ndërkohë që në bazë të akteve të cilat janë administruar nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidatja {...}ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës në datën 20.07.2012, ka përfunduar ciklin e dytë të studimeve Master në “E drejtë civile” pranë Universitetit të Tiranës në vitin 2014 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2018. Me vendim nr. 131, datë 19.07.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor emërohet gjyqtare. Me vendim nr. 152, datë 30.07.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor caktohet në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë. Me procesverbal të Mbledhjes së Përgjithshme të Gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, në datën 04.03.2022 zgjidhet Zëvendëskryetare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë dhe nga data 01.05.2023 ushtron funksionin si gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër. Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 3 vite. Znj {...}aktualisht nuk rezulton të ketë masa disiplinore në fuqi.

Në lidhje me përvojën specifike profesionale në pesë vitet e fundit, sipas informacionit të përcjellë nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të

Përgjithshëm Shkodër, nga verifikimet e kryera rezulton se: ...sipas verifikimeve të bëra në regjistrat që ndodhen në ish Gjykatën Rrethit Gjyqësor Pukë, sot Zyra e Shërbimit Pukë, dhe në sistemin e menaxhimit të çështjeve gjyqësore ju vëmë në dispozicion informacion si më poshtë vijon: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë nuk ka qenë e ndarë me seksione. Gjyqtarja {...} pranë kësaj gjykate ka gjykuar të gjithë llojet e çështjeve është emëruar me datë 19.07.2019; nga data 11.05.2021 – 01.03.2022 me leje lindje dhe nga 01.03.2022 e aktualisht: viti 2019 – ka gjykuar 10 çështje civile; viti 2020 – ka gjykuar 68 çështje civile; viti 2021 – ka gjykuar 20 çështje civile; viti 2022 – ka gjykuar 46 çështje civile; viti 2023 – ka gjykuar 14 çështje civile.

Nga të dhënat e administruara rezulton që deri në momentin e kandidimit kjo magjistrate ka mbi 1 vit përvojë profesionale specifike minimale si gjyqtare në fushën e së drejtës civile në pesë vitet e fundit përpara kandidimit.

Për kandidaten znj. {...}, gjithashtu u verifikuan edhe kriteret e tjera të cilat në rast verifikimi do të ndalonin konkurrimin e mëtejshëm, pra “mospasja e masës disiplinore në fuqi”. Aktualisht nuk rezulton të ketë një masë të tillë. Gjithashtu nuk ndodhet në kushtet e papajtueshmërisë ambientale, në rast hipotetik të lëvizjes/transferimit të saj në gjykatën ku konkurren.

Në këto kushte, nga ana e relatorit bashkë me relacionin u përpilua edhe projektvendimi, në dispozitivin e të cilit ju sugjerohet të miratoni:

1. Kualifikimin e kandidates {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 14 dhe nr.15 datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016.

Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit!

Nëse nuk kemi diskutime, kalojmë në votimin e projekt-aktit. Ilir!

**Ilir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Pro.

*Dritan Hallunaj*: Pro.

*Ridvan Hado*: Dakord.

*Alban Toro*: Dakord.

*Fatmira Luli*: Dakord.

*Naureda Llagami*: Marçela!

*Marçela Shehu*: Dakord.

*Naureda Llagami*: Yllka!

*Yllka Rupa*: Pro.

*Brikena Ukperaj*: Pro.

*Klodian Kurushi*: Dakord.

*Naureda Llagami*: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Kualifikimin e kandidates {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 14 dhe nr.15 datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 5 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 24.07.2023)*

**Pika 6 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.19, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

*Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.*

*Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:12 dhe mbaroi në orën 11:38.*

Në mbledhje ishin të pranishëm nëpërmjet platformës\* dhe në sallë:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Illir Rusi* (zëvendëskryetar)\*
3. *Klodian Kurushi* (anëtar)
4. *Fatmira Luli* (anëtare)
5. *Irena Plaku* (anëtare)
6. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
7. *Ridvan Hado* (anëtar)
8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Marçela Shehu* (anëtare)\*

*10. Brikena Ukperaj (anëtare)*

*11. Yllka Rupa (anëtare)\**

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

*1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*

*2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*

*3. Etrita Petriti, Drejtore e Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative.*

*4. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*

*5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.*

*6. Valbona Bala, Eksperte (EWMI-INL).*

*7. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*

#### **RENDI I DITËS:**

6. Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.19, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

*Naureda Llagami:* Kalojmë tek projekt-akti tjetër që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.19, datë 18.01.2023. Fjalën e ka sërish si relator, z. Toro.

*Alban Toro:* Faleminderit!

Edhe në këtë relacion pasqyrohet konkurrimi që kanë bërë disa gjyqtarë, ndër të tjerë edhe z. {...}, në lidhje me pozicionet e hapura në kuadër të lëvizjes paralele, të bërë për Gjykatën e Shkallës së Parë Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr.19, datë 18.01.2023 dhe aktualisht është gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.

Me Vendimin nr. 374, datë 13.07.2023 nga ana e Këshillit është filluar procedura e verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Durrës, të shpallura me vendimet nr. 14, nr. 19 dhe nr. 24, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatët që kanë ose mund të kenë 1 (një) vlerësim.

Për zotin {...} u administruan aktet të cilat do të provonin plotësinë e kriterëve formale në këtë konkurrim. Aktualisht, së pari u mor ose u analizua përvoja profesionale specifike minimale. Natyrisht që në këtë aspekt e rëndësishme është që të ketë të paktën një vit përvojë profesionale si gjyqtar në fushën e së drejtës civile në 5 vitet e fundit përpara kandidimit. Dhe në këtë kuadër, nga aktet që janë administruar nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, rezulton që kandidati {...} ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës në datën 19.07.2012, ka përfunduar ciklin e dytë të studimeve Master në “E Drejtë Publike”, pranë Universitetit të Tiranës në vitin 2014 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2018. Me vendim nr. 132, datë 19.07.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor emërohet gjyqtar. Me vendim nr. 148, datë 30.07.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor caktohet në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. Me procesverbal të Mbledhjes së Përgjithshme të Gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, në datën 07.04.2023 zgjidhet Zëvendëskryetar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe nga data 01.05.2023 ushtron funksionin si Zëvendëskryetar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë. Vjetërsia aktuale në ushtrimin e funksionit është 3 vite. Zoti {...} aktualisht nuk ka asnjë masë disiplinore në fuqi.

Në lidhje me përvojën specifike profesionale në pesë vitet e fundit, sipas informacionit të përcjellë nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, nga verifikimet e kryera, rezulton se: Me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor

nr. 148, datë 30.07.2019, gjyqtari i emëruar {...}, caktohet pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, nuk ka qenë e ndarë në seksione për shkak të numrit të vogël të gjyqtarëve, gjyqtarët kanë gjykuar të gjitha llojet e çështjeve gjyqësore si civile ashtu dhe penale. Gjyqtar {...}, ka gjykuar në total për periudhën korrik 2019 – dhjetor 2022, 841 çështje gjyqësore civile.

Nga të dhënat e administruara në këtë verifikim, rezulton që deri në momentin e kandidimit në kuadër të lëvizjes paralele, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 19, datë 18.01.2023, rezulton të ketë mbi një vit përvojë profesionale specifike minimale si gjyqtar në fushën e së drejtës civile në pesë vitet e fundit përpara kandidimit.

Gjithashtu u verifikua edhe ekzistenca e kushteve të tjera të cilat do të ndalonin konkurrimin, por që në fakt nuk janë verifikuar. Bëhet fjalë për kriterin e “mospasjes së masës disiplinore në fuqi”, që zoti {...} nuk ka një të tillë. Gjithashtu u verifikua edhe kriteri i papajtueshmërisë ambientale në rast hipotetik të lëvizjes së tij dhe nuk rezulton të jetë i verifikueshëm edhe ky shkak skualifikues.

Kështu që, në këto kushte, nga ana e relatorit u përpilua projektvendimi, në dispozitivin e të cilit ju sugjerohet të miratoni:

1. Kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 19, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016, me ndryshime.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit!

Nëse nuk kemi diskutime, kalojmë në miratimin e projekt-aktit. Ilir!

**Ilir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Pro.

*Dritan Hallunaj*: Pro.

*Ridvan Hado*: Dakord.

*Alban Toro*: Dakord.

*Fatmira Luli*: Dakord.

*Marçela Shehu*: Dakord.

*Yllka Rupa*: Pro.

*Brikena Ukperaj*: Pro.

*Klodian Kurushi*: Dakord.

*Naureda Llagami*: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 19, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 6 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 24.07.2023)*

**Pika 7 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 248 dhe nr. 251, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:12 dhe mbaroi në orën 11:38.***

Në mbledhje ishin të pranishëm nëpërmjet platformës\* dhe në sallë:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)\*
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Irena Plaku*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)

9. *Marçela Shehu* (anëtare)\*  
10. *Brikena Ukperaj* (anëtare)  
11. *Yllka Rupa* (anëtare)\*

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Etrita Petriti, Drejtore e Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative.*
4. *Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
5. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.*
6. *Valbona Bala, Eksperte (EWMI-INL).*
7. *Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*

#### **RENDI I DITËS:**

7. Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 248 dhe nr. 251, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

*Naureda Llagami:* Kalojmë tek projekt-akti tjetër që ka të bëjë me kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan. Për më shumë detaje, fjalën ia jap z. Kurushi.

*Klodian Kurushi:* Faleminderit!

Me disa vendime të datës 24.05.2023, Këshilli i Lartë Gjyqësor hapi 8 procedura të lëvizjeve paralele në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, ndër to, me vendimin nr. 248 dhe nr. 251, procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile.

Afati i kandidimit për këto procedura të lëvizjes paralele u përcaktua deri më datë 14.06.2023.

Brenda afatit të kandidimit për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallura me vendimet nr. 248 dhe nr. 251, datë 24.05.2023 kandidoi edhe z. {...}, me detyrë gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.

Në pozicionin nr. 248 dhe nr. 251 nuk kishte kandidatë të kualifikuar me 2 (dy) vlerësime / apo 1 (një) vlerësim. Në këto rrethana Këshilli me vendimin nr. 385, datë 17.07.2023 ka vendosur: “Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, të shpallura me vendimet nr. 248, 250, 251, 253 datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatët që nuk kanë dhe që nuk mund të kenë asnjë vlerësim. Caktimin e relatorit: 4. Për kandidatin z. {...}, u caktova unë nëpërmjet shortit të zhvilluar në mbledhjen e asaj dite.

Në vijim të procedurës së verifikimit, po parashtroj rezultatet e verifikimit të kriterëve të kandidimit.

Për kandidatin z. {...} u verifikua kriteri i “Përvojës profesionale specifike minimale”. Në lidhje me përvojën profesionale në kërkesën për shprehje interesi dhe jetëshkrimin e dorëzuar nga kandidati, evidentohet se ai ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2020 dhe ka ushtruar detyrën pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec prej datës 29.01.2020. Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit Korçë ai vazhdon të ushtrojë funksionin e gjyqtarit.

Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, zoti {...}. Ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” në datën 11.07.2012, ka përfunduar ciklin e dytë të studimeve Master në “E drejtë penale” pranë Universitetit të Tiranës në vitin 2014.

Me vendim nr. 5, datë 09.01.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor emërohet gjyqtar.

Me vendim nr. 50, datë 29.01.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor caktohet në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.

Me vendim nr. 365, datë 14.09.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor transferohet përkohësisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë, për një periudhë deri në 1 (një) vit.

Me vendim nr. 390, datë 19.09.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor i përsëritet transferimi i përkohshëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë deri më datën 01.05.2023 dhe aktualisht ushtron funksionin e gjyqtarit pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.

Në lidhje me përvojën specifike profesionale në pesë vitet e fundit, sipas informacionit të përcjellë nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, nga verifikimet e kryera, rezultoi se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec nuk ka qenë e ndarë në seksione për shkak të numrit të vogël të gjyqtarëve dhe gjyqtarët kanë gjykuar të gjitha llojet e çështjeve gjyqësore si civile ashtu dhe penale. Me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor i datës 14.09.2021, është vendosur transferimi i përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë të gjyqtarit z. {...}, për një periudhë deri në një vit, që mund të ndërpritet në rast të ndryshimit të rrethanave. Më pas, siç thamë është ripërsëritur edhe një herë transferimi i përkohshëm i tij.

Sipas informacionit të përcjellë nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, nga verifikimet e kryera, rezultoi se: “Në vijim të e-mailit të dërguar nga ana juaj, gjyqtari z. {...}, për periudhën 14 shtator 2021 deri në 1 maj 2023, ka gjykuar çështje penale dhe civile në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë, pasi organika e kësaj gjykate nuk e mundësonte ndarjen në dhoma civile dhe penale.”

Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, kandidati z. {...}, deri në momentin e kandidimit për lëvizjen paralele, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimet e cituara më lart, rezulton të ketë mbi një vit përvojë profesionale specifike minimale si gjyqtar në fushën e së drejtës civile gjatë pesë viteve të fundit përpara kandidimit të tij.

Për kandidatin z. {...} u verifikua edhe kriteri i “mospasjes masë disiplinore në fuqi”.

Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, nuk rezulton që zoti {...} të ketë masë disiplinore në fuqi.

Për kandidatin z. {...} u verifikua edhe kriteri i “papajtueshmërisë ambientale” i cili është kriter ndalues për lëvizjen paralele, referuar shkronjës “c”, të pikës 5, të vendimit 248/2023 dhe 251/2023 si dhe nenit 8, pika 2, të Ligjit për Statusin.

Nga verifikimet e bëra dhe nga dokumentacioni i administruar ka rezultuar se gjatë verifikimit për kandidatin {...} nuk vërtetohet të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale në rast të transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

Përfundimisht, pasi kemi realizuar verifikimet e kryera Komisioni propozon kualifikimin e kandidatit dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimin nr. 248 dhe nr. 251, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit.

Ky vendim hyn në fuqi dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit!

Nëse nuk kemi diskutime, kalojmë në votimin e tij. Ilir!

**Ilir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Naureda Llagami:** Marçela!

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Naureda Llagami:** Yllka!

**Yllka Rupa:** Pro.

***Brikena Ukperaj***: Pro.

***Klodian Kurushi***: Dakord.

***Naureda Llagami***: Dakord.

Atëherë, miratohet projekt-akti sipas propozimit të ardhur nga Komisioni.

\* \* \*

(Pika 7 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 24.07.2023)*

**Pika 8 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidates {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 248 datë 24.05.2023, dhe për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 253, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Dritan Hallunaj).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:12 dhe mbaroi në orën 11:38.***

Në mbledhje ishin të pranishëm nëpërmjet platformës\* dhe në sallë:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)\*
- 3. Klodian Kurushi*** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli*** (anëtare)
- 5. Irena Plaku*** (anëtare)
- 6. Dritan Hallunaj*** (anëtar)
- 7. Ridvan Hado*** (anëtar)

- |                            |                   |
|----------------------------|-------------------|
| <i>8. Alban Toro</i>       | <i>(anëtar)</i>   |
| <i>9. Marçela Shehu</i>    | <i>(anëtare)*</i> |
| <i>10. Brikena Ukperaj</i> | <i>(anëtare)</i>  |
| <i>11. Yllka Rupa</i>      | <i>(anëtare)*</i> |

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Etrita Petriti, Drejtore e Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative.*
- 4. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.*
- 6. Valbona Bala, Eksperte (EWMI-INL).*
- 7. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*

#### **RENDI I DITËS:**

8. Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 248 datë 24.05.2023, dhe për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 253, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Dritan Hallunaj).

*Naureda Llagami:* Kalojmë tek projekt-akti i radhës, që ka të bëjë edhe ky me kualifikimin e kandidatës {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan. Për këtë është relator z. Hallunaj.



**Dritan Hallunaj:** Me disa vendime të Këshillit të Lartë Gjyqësor në procedurën e lëvizjes paralele, të datës 24.05.2023 janë hapur 8 procedura të lëvizjes paralele, ndër to, me vendimin nr. 248 dhe nr. 253, procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksioni të Përgjithshëm Elbasan.

Është përcaktuar afati dhe brenda afatit ka kandiduar dhe kandidatja {...}, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.

Meqenëse në pozicionin nr. 248 dhe nr. 253 që i referohen lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksioni të Përgjithshëm Elbasan nuk kishte kandidatë të kualifikuar me 2 (dy) vlerësime, në këto rrethana Këshilli me vendimin nr. 385, datë 17.07.2023 ka vendosur: “Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, të shpallura me vendimet nr. 248, 250, 251, 253 datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatët që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim.”, duke përcaktuar edhe relatorin.

Janë kryer procedurat, duke njoftuar gjyqtaren.

Në vijim janë kryer rezultatet e verifikimit të kriterëve të kandidimit.

Për kandidaten {...} u verifikua kriteri i “Përvojës profesionale specifike minimale”.

Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, znj. {...}, ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, më 12.07.2010 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2020.

Me vendim nr. 483, datë 20.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor emërohet gjyqtare.

Me vendim nr. 505, datë 27.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor caktohet në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe nga data 01.05.2023 ushtron funksionin si gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.

Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 2 vite.

Pra në këto kushte nga dokumentacioni i administruar rezulton se gjatë verifikimit, kandidatja znj. {...}, deri në momentin e kandidimit për lëvizjen paralele,

për pozicionet e lira të shpallura me vendimet e Këshillit nr. 248 dhe nr. 253 datë 24.05.2023, rezulton të ketë mbi një vit përvojë profesionale specifike minimale si gjyqtare në fushën e së drejtës civile/penale gjatë pesë viteve të fundit përpara kandidimit.

Është verifikuar kriteri i “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe nuk ka rezultuar që të ketë një të tillë.

Gjithashtu është verifikuar edhe kriteri i “papajtueshmërisë ambientale”, ku nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, për kandidaten znj. {...} nuk vërtetohet të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale në rast të transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

Në këto kushte, duke vlerësuar procedurën e plotë i është përcjellë Komisionit të Zhvillimit të Karrierës dhe ky komision ia ka parashtruar seancës plenare, duke vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur për kualifikimin e kandidates {...} dhe vijimin e procedurës për pozicionet e lira, të shpallura me vendimet nr. 248 dhe nr. 253, datë 24.05.2023.

Faleminderit!

*Naureda Llagami:* Faleminderit!

Nëse nuk kemi diskutime, kalojmë në votimin e projekt-aktit. Ilir!

*Ilir Rusi:* Dakord.

*Irena Plaku:* Pro.

*Dritan Hallunaj:* Pro.

*Ridvan Hado:* Dakord.

*Alban Toro:* Dakord.

*Fatmira Luli:* Dakord.

*Marçela Shehu:* Dakord.

*Yllka Rupa:* Pro.

*Brikena Ukperaj:* Pro.

*Klodian Kurushi:* Dakord.

*Naureda Llagami:* Dakord.

Atëherë, miratohet projekt-akti sipas propozimit të ardhur nga Komisioni.

\* \* \*

(Pika 8 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 24.07.2023)*

**Pika 9 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin 250, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Dritan Hallunaj).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:12 dhe mbaroi në orën 11:38.***

Në mbledhje ishin të pranishëm nëpërmjet platformës\* dhe në sallë:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Illir Rusi*** (zëvendëskryetar)\*
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Irena Plaku*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Marçela Shehu*** (anëtare)\*

**10. Brikena Ukperaj** (anëtare)

**11. Yllka Rupa** (anëtare)\*

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Etrita Petriti, Drejtore e Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative.**
- 4. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.**
- 6. Valbona Bala, Eksperte (EWMI-INL).**
- 7. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**

#### **RENDI I DITËS:**

9. Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin 250, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Dritan Hallunaj).

**Naureda Llagami:** Kalojmë tek projekt-akti i radhës, që ka të bëjë me kualifikimin e kandidatit z. {...} edhe ky për vijimin e procedurës së lëvizjes paralele. Sërish fjalën e ka z. Hallunaj.

**Dritan Hallunaj:** Me disa vendime të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datës 24.05.2023 janë hapur 8 procedura të lëvizjeve paralele në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, ndër to, me vendimin nr. 250, procedura e lëvizjes paralele

në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksioni të Përgjithshëm Elbasan, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile.

Meqenëse në pozicionin nr. 250 që i referohet lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksioni të Përgjithshëm Elbasan nuk kishte kandidatë të kualifikuar me 2 (dy) vlerësime / apo 1 (një) vlerësim, në këto rrethana Këshilli me vendimin nr. 385, datë 17.07.2023 vendosi: Fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për vendet e shpallura, si dhe duke caktuar relatorin, pra për kandidatët që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim.

Pasi janë kryer procedurat, është vijuar me rezultatet e verifikimit të kritereve të kandidimit.

Për kandidatin z. {...} u verifikua kriteri i “Përvojës profesionale specifike minimale” dhe ka rezultuar që ky magjistrat ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës në vitin 2008 dhe Shkollën e Magjistraturës në vitin 2020.

Me vendim nr. 471, datë 20.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor emërohet gjyqtar.

Me vendim nr. 513, datë 27.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor caktohet në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet.

Me vendim nr. 16, datë 17.01.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor transferohet përkohësisht pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër.

Me vendim nr. 38, datë 23.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor i përsëritet transferimi i përkohshëm pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër dhe nga data 01.05.2023 ushtron funksionin si gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër.

Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 2 vite.

Z. {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Lidhur me përvojën specifike për pesë vitet e fundit, sipas informacionit të përcjellë nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, nga verifikimet e kryera, rezultoi se: “Në përgjigje të e-mailit tuaj më lejoni t’ju bëj me dije se gjyqtar z. {...} ushtron detyrën pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të

Përgjithshëm Gjyrokastër, që prej periudhës janar 2022 dhe në vijimësi. Ju bëj me dije se gjykata jonë nuk është e ndarë në seksione (civile dhe penale) për këtë arsye gjyqtar z. {...} ka gjykuar çështje me karakter civil dhe penal. Vlen të përmendet fakti se për vitin 2022, pjesa më e madhe e ngarkesës së punës është përballuar vetëm nga dy gjyqtarë që janë z. {...} dhe znj. {...}. Zoti {...} është caktuar për të gjykuar edhe çështje në seksionin e të miturve. Në lidhje me përvojën e gjyqtar z. {...}, është caktuar gjyqtar në datën 27 tetor 2020 me vendimin me nr.513 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet. Nga verifikimi rezultoi se z. {...} ka gjykuar çështje me karakter civil, penal, dhe çështje me të mitur, për arsye se kjo gjykatë nuk ka qenë e ndarë në dhoma të veçanta.

Në këto kushte, nga të dhënat dhe dokumentacioni i paraqitur, rezulton se kandidati z. {...}, deri në momentin e kandidimit për lëvizjen paralele, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 250, datë 24.05.2023, rezulton të ketë mbi një vit përvojë profesionale specifike minimale si gjyqtar në fushën e së drejtës civile gjatë pesë viteve të fundit përpara kandidimit.

Gjithashtu është verifikuar kriteri i “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe ka rezultuar që nuk ka një të tillë.

Gjithashtu është verifikuar edhe kriteri i papajtueshmërisë ambientale dhe nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, për kandidatin z. {...} nuk vërtetohet të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale në rast të transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

Në këto kushte është paraqitur në Komision çështja, dhe Komisioni ka vendosur kalimin për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor për kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 250, datë 24.05.2023.

Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit!

Atëherë, kalojmë në votimin e projekt-aktit. Ilir!

**Ilir Rusi:** Dakord.

*Irena Plaku*: Pro.

*Dritan Hallunaj*: Pro.

*Ridvan Hado*: Dakord.

*Alban Toro*: Dakord.

*Fatmira Luli*: Dakord.

*Marçela Shehu*: Dakord.

*Yllka Rupa*: Pro.

*Brikena Ukperaj*: Pro.

*Klodian Kurushi*: Pro.

*Naureda Llagami*: Dakord.

Atëherë, miratohet projekt-akti sipas propozimit të sjellë nga Komisioni.

\* \* \*

(Pika 9 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 24.07.2023)*

**Pika 10 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e pensionit të parakohshëm dhe mbarimin e statusit të magjistratit për z. {...}, gjyqtarit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).<sup>1</sup>

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:12 dhe mbaroi në orën 11:38.***

Në mbledhje ishin të pranishëm nëpërmjet platformës\* dhe në sallë:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)\*
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Irena Plaku*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Marçela Shehu*** (anëtare)\*

<sup>1</sup> Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej si pikë e 12-të në rendin e ditës.

**10. Brikena Ukperaj** (anëtare)

**11. Yllka Rupa** (anëtare)\*

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

**1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**

**2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**

**3. Etrita Petriti, Drejtore e Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative.**

**4. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**

**5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.**

**6. Valbona Bala, Eksperte (EWMI-INL).**

**7. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**

#### **RENDI I DITËS:**

10. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e pensionit të parakohshëm dhe mbarimin e statusit të magjistratit për z. {...}, gjyqtarit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

**Naureda Llagami:** Kalojmë tek projekt-akti që ka të bëjë me miratimin e pensionit të parakohshëm dhe mbarimin e statusit të magjistratit për z. {...}. Për më shumë detaje, fjalën ia jap z. Toro.

**Alban Toro:** Faleminderit!

Atëherë, më lejoni ta pasqyroj në mënyrë të sintetizuar këtë material, në kushtet kur nëpërmjet rrjetit elektronik është shpërndarë dhe ka pasur kohë të mjaftueshme për t’u njohur me përmbajtjen e tij.

Pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, më datë 11.07.2023, është depozituar një kërkesë nga gjyqtari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, z. {...}, me nr. 3893 prot, me objekt miratimin e pensionit të parakohshëm, referuar nenit 27 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Si shkak të paraqitjes së kërkesës, magjistrati ka parashtruar moshën e tij, mbi 60 vjeç dhe funksionin si gjyqtar.

Më konkretisht ai e ka shprehur vullnetin e tij në këtë shkresë duke u shprehur se: “Unë gjyqtar {...}, duke shprehur vlerësimin tim maksimal për punën dhe kontributin tuaj në mbarëvajtjen e sistemit gjyqësor parashtrroj kërkesën time për daljen në pension të parakohshëm, bazuar si më poshtë:

Unë jam i datëlindjes 20.03.1959 dhe kam filluar punë si gjyqtar më datë 20.12.1990, detyrë të cilën e ushtroj pa ndërprerje dhe aktualisht jam gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër. Bazuar në parashikimet ligjore, plotësoj kushtet për daljen në pension të parakohshëm sepse kam 33 vjet gjyqtar dhe aktualisht jam 64 vjeç. Në këto kushte kërkoj të më pranohet kërkesa pasi plotësoj dhe të dy kushtet që përcakton ligji, konkretisht neni 27 i ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. [...]. Të dhënat e detajuara ndodhen në dosjen time personale të cilën Këshilli e disponon dhe e administron.

Sa më sipër mendoj se kërkesa ime është e bazuar në ligj dhe kërkoj të më pranohet.”.

Nga informacioni i marrë në rrugë elektronike nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit rezulton se:

“Zoti {...}, ka përfunduar studimet në degën Shkenca Juridike dhe Politike, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës në datën 05.07.1989 (sistemi pa shkëputje nga puna).

Me vendim nr. {...}, datë 02.02.1991 të Këshillit Popullor të Rrethit Mat zgjidhet gjyqtar popullor në Gjykatën e Rrethit Mat.

Me vendim nr. {...}, datë 14.05.2009 të Këshillit të Lartë Gjyqësor pranohet pjesërisht kërkesa për procedim disiplinor dhe dërgohet për të ushtruar detyrën si gjyqtar për 1 vit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

Me procesverbal të Mbledhjes së Përgjithshme të Gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, datë 23.03.2022 zgjidhet Zëvendëskryetar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat dhe nga data 01.05.2023 ushtron funksionin e magjistratit (gjyqtar) pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.

Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 32 vite.

Zoti Lleshi nuk ka masa disiplinore në fuqi."

Kërkesa është e bazuar në nenin 27 të Ligjit për Statusin. Në këtë dispozitë përcaktohet ndër të tjera se magjistrati gëzon të drejtën e pensionit të parakohshëm nëse: a) ka mbushur të paktën moshën 60 vjeç, b) ka ushtruar funksionin e magjistratit për të paktën 30 vjet, duke përfshirë edhe periudhën e komandimit.

Pensioni i parakohshëm i pleqërisë parashikuar nga neni 27, shkronja "a" e ligjit "Për statusin", përfaqëson një institucion atipik pensioni pleqërie. Ky Institucion përfshihet në sistemin e garancive të parashikuara nga neni 138 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ka si qëllim të përmirësojë sistemin e kujdesit social për magjistratët në mënyrë që të garantohen përfitime financiare në përputhje me dinjitetin e detyrës së magjistratit edhe në rastet kur nuk janë plotësuar kushtet për pensionin e plotë të pleqërisë.

Në këtë nen përcaktohet, ndër të tjera, se: "Magjistrati gëzon të drejtën e pensionit të parakohshëm nëse: a) ka mbushur të paktën moshën 60 vjeç; b) ka ushtruar funksionin e magjistratit për të paktën 30 vjet, duke përfshirë edhe periudhën e komandimit; etj."

Ndaj sa më sipër rezulton se kërkuesi i plotëson të dy kriteret e përcaktuara nga ligji, moshën, të paktën 60 vjeç dhe ushtrimin e funksionit të magjistratit për të paktën 30 vjet, për përfitimin nga skema e sigurimeve shoqërore të pensionit të parakohshëm. Në kushte të tilla kërkesa e magjistratit është një kërkesë e bazuar në ligj dhe në prova dhe si e tillë duhet pranuar.

Dhënia e dorëheqjes apo dalja në pension të parakohshëm e magjistratit, përbëjnë rastet e mbarimit të vullnetshëm të statusit të magjistratit. Në këtë mënyrë, magjistrati nëpërmjet kërkesave respektive shpreh vullnetin e tij për të mos qëndruar në detyrë dhe për të mos ushtruar atë, dhe si rrjedhojë për të mos gëzuar statusin e magjistratit deri në mbushjen e moshës maksimale 67 vjeç, moshë e cila përcaktohet në Ligjin e Posaçëm si moshë e daljes në pension të plotë pleqërie. Kjo logjikë e interpretimit të dispozitës del

në pah dhe në parashikimet e nenit 27, pika 1/2 të ligjit sipas të cilit pensioni i parakohshëm mbetet i reduktuar gjatë gjithë kohës së përfitimit deri në plotësimin e kushteve për përfitimin e pensionit të plotë të pleqërisë.

Në lidhje me përcaktimin e efekteve të këtij vendimi është marrë në konsideratë nga ana e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës dhe ngarkesa aktuale e gjyqtarit. Pas verifikimit në sistemin e menaxhimit të çështjeve të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër rezulton se gjyqtari {...} në datën 19.07.2023 ka për gjykim 26 çështje (9 çështje civile dhe 17 çështje penale). Nga 9 çështjet civile rezulton se 3 janë në seancë gjyqësore, 1 në fazën e konkluzioneve dhe 5 çështje civile në seancë “pajtim” apo “veprime përgatitore”. Ndërsa nga 17 çështjet penale, rezulton se 5 janë të pezulluara, 1 në fazën e konkluzioneve, 2 në seancë gjyqësore dhe 9 të tjerë në seancën e parë (pa filluar seanca gjyqësore).

Në këtë kuadër nga ana jonë është caktuar si datë për efektet juridike të këtij vendimi data 15.09.2023.

Përfundimisht nga ana e relatorit u përgatit ky projektvendim, në dispozitivin e të cilit ju sugjerohet të miratoni:

1. Pranimin e kërkesës.
2. Miratimin e pensionit të parakohshëm për magjistratin z. {...}.
3. Pensioni i parakohshëm për magjistratin z. {...} llogaritet dhe paguhet nga organet e sigurimeve shoqërore sipas përcaktimeve të nenit 27, pika 1/2, të Ligjit nr. 96/2016.
4. Mbarimin e statusit të magjistratit z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, për shkak të daljes në pension të parakohshëm pleqërie.
5. Efektet juridike të urdhërimeve sipas pikave 3 dhe 4, të këtij vendimi, fillojnë më datë 15.09.2023.
6. Përrjashtimin e menjëhershëm të gjyqtarit z. {...} nga procedurat e ndarjes së çështjeve gjyqësore në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.
7. Një kopje e vendimit i njoftohet magjistratit, gjyqtarit z. {...}, Gjykatës së

Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

8. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit z. Toro!

Atëherë, nëse nuk kemi ndonjë diskutim, kalojmë në miratimin e projekt-aktit. Ilir!

**Ilir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Pranimin e kërkesës.
2. Miratimin e pensionit të parakohshëm për magjistratin z. {...}.
3. Pensioni i parakohshëm për magjistratin z. {...} llogaritet dhe paguhet nga organet e sigurimeve shoqërore sipas përcaktimeve të nenit 27, pika 1/2, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

4. Mbarimin e statusit të magjistratit z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, për shkak të daljes në pension të parakohshëm pleqërie.

5. Efektet juridike të urdhërimeve sipas pikave 3 dhe 4, të këtij vendimi, fillojnë më datë 15.09.2023.

6. Përcaktimin e menjëhershëm të gjyqtarit z. {...} nga procedurat e ndarjes së çështjeve gjyqësore në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.

7. Një kopje e vendimit i njoftohet magjistratit, gjyqtarit z. {...}, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

8. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor

\* \* \*

(Pika 10 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 24.07.2023)*

**Pika 11 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimeve “Për transferimin e gjyqtarit z. {...} në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Dritan Hallunaj);<sup>2</sup> **Shtesë në rendin e ditës:** “Për përfundimin para afatit të transferimit të përkohshëm me pëlqim për gjyqtarin z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:12 dhe mbaroi në orën 11:38.***

Në mbledhje ishin të pranishëm nëpërmjet platformës\* dhe në sallë:

- 1. Naureda Llagami** (kryetare)
- 2. Ilir Rusi** (zëvendëskryetar)\*
- 3. Klodian Kurushi** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli** (anëtare)
- 5. Irena Plaku** (anëtare)
- 6. Dritan Hallunaj** (anëtar)
- 7. Ridvan Hado** (anëtar)

<sup>2</sup> Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej si pikë e 10-të në rendin e ditës.



8. *Alban Toro* (anëtar)  
9. *Marçela Shehu* (anëtare)\*  
10. *Brikena Ukperaj* (anëtare)  
11. *Yllka Rupa* (anëtare)\*

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Etrita Petriti, Drejtore e Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative.*
4. *Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
5. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.*
6. *Valbona Bala, Eksperte (EWMI-INL).*
7. *Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*

#### **RENDI I DITËS:**

11. Shqyrtimi i projektvendimeve “Për transferimin e gjyqtarit z. {...} në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Dritan Hallunaj); Shtesë në rendin e ditës: “Për përfundimin para afatit të transferimit të përkohshëm me pëlqim për gjyqtarin z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

*Naureda Llagami*: Atëherë, kalojmë në aktet e tjera.

Siç jeni në dijeni, sot kemi edhe dy aktet e fundit që kanë të bëjnë me transferimin e gjyqtarëve, konkretisht z. {...} dhe znj. {...}.

Pasi të miratojmë transferimin më pas do miratojmë edhe projekt-aktin tjetër që i është vënë në dijeni Këshillit ditën e premte, që ka të bëjë me përfundimin para afatit të transferimit të përkohshëm me pëlqim për gjyqtarëve respektivë.

Kështu fillojmë me z. {...}.

Pa humbur kohë fjalën ia japim z. Hallunaj lidhur me transferimin e gjyqtarit.

***Dritan Hallunaj:*** Faleminderit!

Po parashtroj relacionin për transferimin e gjyqtarit {...} në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Me disa vendime të datës 18.01.2023, Këshilli i Lartë Gjyqësor hapi katërmbëdhjetë procedura të lëvizjeve paralele në gjykatat e shkallës së parë, ndër to, me vendimin nr. 16 dhe nr. 18, procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në fushën e të drejtës civile.

Brenda afatit të kandidimit ka kandiduar edhe z. {...}, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, aktualisht i transferuar përkohësisht në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë sipas vendimit të Këshillit nr. 95, datë 06.03.2023.

Mbas përfundimit të afatit të kandidimit për procedurat e lëvizjes paralele dhe përcaktimit nga kandidatët të interesit për tre procedurat në proces, mbi propozimin e Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, Këshilli miratoi listën e kandidatëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime etike dhe profesionale për efekt të kandidimit në procedurat e shpallura të lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë. Në këtë listë është përfshirë dhe z. {...}.

Në vijim, me vendimin nr. 115, datë 13.03.2023, Këshilli ka vendosur: “I. Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë e Durrës, të shpallura me vendimet, ndër të tjera, nr. 16, nr. 18, datë 18.01.2023, për kandidatët që kanë ose mund të kenë 2 (dy) vlerësime, si dhe është përcaktuar edhe relatori.

Në vijim është vijuar nga ana e Këshillit duke evidentuar kandidatët që përmbushin kriteret e kandidimit si dhe Këshilli ka realizuar procedurat e verifikimit dhe plotësimin nga i vetmi kandidat të kriterëve të mëposhtme që është:

- 1) “përvojës profesionale minimale”;
- 2) “mospasjes masë disiplinore në fuqi”;
- 3) “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

Kështu, për kandidatin e vetëm, z. {...}, në përfundim të fazës së parë të lëvizjes paralele në përputhje me parashikimet e Kreut V të vendimit 320/2020, Këshilli verifikoi plotësimin nga ai të kriterëve të kandidimit.

Kandidati {...} është tërhequr nga kandidimi i tij për pozicionin e shpallur me vendimin nr.18/2023 dhe Këshilli ndër të tjera ka vendosur ndër të tjera, përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele.

Siç u parashtrua, krahas procedurave të verifikimit të kriterëve të kandidimit, paralelisht, për kandidatin kanë vijuar edhe procedurat e vlerësimit etik dhe profesional. Duke qenë se kandidati përfshihej në listën e gjyqtarëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime për të ishte e nevojshme përfundimi i vlerësimeve, konkretisht: 1) vlerësimi me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013–2016 (periudhën e rivlerësimit kalimtar), referuar pikës 5, të nenit 171, të Ligjit për Statusin; 2) vlerësimi periodik për periudhën 2017-2019.

Me kualifikimin e kandidatit z. {...}, bazuar në pikën 75 të vendimit të Këshillit “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”, Këshilli, me Vendimin nr. 294, datë 30.05.2023, vendosi fillimin e procedurave të përzgjedhjes së kandidatëve, duke përcaktuar edhe relatorin përkatës.

Në vijim janë përcaktuar edhe të gjitha veprimet procedurale të kryera nga ana e Këshillit dhe konkretisht konstatohet që :

Lidhur me vlerësimet etike dhe profesionale, për kandidatin e vetëm z. {...} u konstatua se: Me vendimin e Këshillit nr. 121 datë 15.03.2023, kandidati është vlerësuar për periudhën 2017-2019, në nivelin e përgjithshëm “Shkëlqyeshëm”, duke grumbulluar në total 391 pikë, sipas “Raportit të vlerësimit etik dhe profesional” të miratuar me këtë vendim. b) Me vendimin nr. 351, datë 06.07.2023, Këshilli e ka vlerësuar për vitet 2013-2016, në nivelin e përgjithshëm “Shkëlqyeshëm”, duke grumbulluar në total 378 pikë.

Dy vlerësimet etike dhe profesionale të kandidatit z. {...} të miratuara me vendimet e sipërcituara, u konstatuan të jenë bërë përfundimtarë, ndërsa ndaj tyre nuk është paraqitur ankim referuar deklaratës së kandidatit të dërguar në rrugë elektronike, më datë 12.07.2023.

Mbi propozimin e relatorit të përzgjedhjes, Këshilli me vendimin e datës 17.07.2023 miratoi vendimin “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 16, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor” duke vendosur:

“Miratimin e renditjes së kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr. 16, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

1. Z. {...}.

Sipas pikës 15, të këtij relacioni është njoftuar rregullisht në rrugë elektronike për këtë vendimmarrje dhe po më datë 17.07.2023 ka konfirmuar marrjen e njoftimit. Gjithashtu ka bërë të ditur Këshillin se nuk do të ushtronte ankim.

Në kushtet kur kandidati ka konfirmuar dakordësinë me vendimin për renditjen, të datës 17.07.2023, si dhe ka deklaruar se nuk do bëjë ankim, ky vendim konsiderohet se ka marrë formë të prerë.

Për rrjedhojë, në zbatim të pikës 111, të vendimit të Këshillit nr.320/2020, relatori i procedurës së përzgjedhjes përgatiti projektvendimin për transferimin e gjyqtarit z. {...} në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 16, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në kushtet kur aktualisht, z. {...} është i transferuar me pëlqim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, sipas vendimit të Këshillit 95/2023, për një periudhë deri 1 vit, Komisioni propozon përfundimin përpara afatit të këtij transferimi me pëlqim, sipas projektit bashkëlidhur.

Projektvendimi është i strukturuar në 3 pika.

Pika 1 e projektvendimit bën fjalë për transferimin e gjyqtarit z. {...} në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile.

Në pikën 2 përcaktohen efektet juridike të këtij vendimi që fillojnë më datë 24, pra ditën e sotme.

Në pikën 3 të projektvendimit përcaktohet se një kopje e vendimit i njoftohet z. {...} sipas kërkesave të ligjit, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Dibër.

Së fundi, në projektvendim përcaktohet hyrja e tij në fuqi dhe publikimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit z. Hallunaj!

**Klodian Kurushi:** Në emër të Komisionit edhe me pëlqimin e zotit Hallunaj, unë do doja të bëja një propozim në lidhje me riformulimin e pjesës së parë të projektvendimit që ne propozojmë në këtë rast (edhe të pikës 2 të projektvendimit). Projektvendimet janë njësoj, si kjo që është lexuar tani nga zoti Hallunaj, ashtu sikundër edhe projektvendimi i dytë që do lexohet nga ana ime.

Meqenëse është hera e parë që ne përdorim procedurën e lëvizjes paralele për të transferuar gjyqtarë në këtë procedurë, unë do të propozoja që pika 1 dhe pika 2 e projektvendimit të lexuar të ndryshohet ose të modifikohet si më poshtë: “1. Transferimin e gjyqtarit z. {...} për shkak të lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.”, - dhe këtu mbyllet.

Pika e dytë “2. Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë më datë 24.07.2023.”. E kemi lënë bosh për shkak të ditës se kur do mbahej mbledhja plenare.

Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit!

Jemi dakord me propozimin që erdhi nga Komisioni.

Po e hedhim projekt-aktin në votim me këtë propozim. Ilir!

**Ilir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Naureda Llagami:** Marçela!

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Naureda Llagami:** Yllka!

**Yllka Rupa:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Transferimin e gjyqtarit z. {...} për shkak të lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

2. Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë më datë 24.07.2023.

3. Një kopje e vendimit i njoftohet z. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**Naureda Llagami:** Kalojmë tek projekt-akti i radhës që ka të bëjë me përfundimin para afatit të transferimit të përkohshëm me pëlqim për gjyqtarin z. {...}. Në situatën që u miratua projekt-akti i parë, jemi dakord? Ilir!

**Ilir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.

*Alban Toro*: Dakord.

*Fatmira Luli*: Dakord.

*Marçela Shehu*: Dakord.

*Yllka Rupa*: Pro.

*Brikena Ukperaj*: Pro.

*Klodian Kurushi*: Dakord.

*Naureda Llagami*: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Përfundimin para afatit të transferimit të përkohshëm me pëlqim, për gjyqtarin z. {...}.

2. Efektet e këtij vendimi fillojnë më datë 24.07.2023.

3. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit z. {...} sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibrë dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 11 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 24.07.2023)*

**Pika 12 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimeve “Për transferimin e gjyqtarës znj. {...} në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë (relator z. Klodian Kurushi);<sup>3</sup> Shtesë në rendin e ditës: “Për përfundimin para afatit të transferimit të përkohshëm me pëlqim për gjyqtaren znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:12 dhe mbaroi në orën 11:38.***

Në mbledhje ishin të pranishëm nëpërmjet platformës\* dhe në sallë:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)\*
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Irena Plaku*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)

<sup>3</sup> Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej si pikë e 11-të në rendin e ditës.



9. *Marçela Shehu* (anëtare)\*  
10. *Brikena Ukperaj* (anëtare)  
11. *Yllka Rupa* (anëtare)\*

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Etrita Petruti, Drejtore e Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative.*
4. *Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
5. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.*
6. *Valbona Bala, Eksperte (EWMI-INL).*
7. *Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*

#### **RENDI I DITËS:**

12. Shqyrtimi i projektvendimeve “Për transferimin e gjyqtares znj. {...} në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë (relator z. Klodian Kurushi); Shtesë në rendin e ditës: “Për përfundimin para afatit të transferimit të përkohshëm me pëlqim për gjyqtaren znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

*Naureda Llagami*: Kalojmë në projekt-aktin tjetër që ka të bëjë me transferimin e gjyqtares znj. {...} në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Për më shumë detaje fjalën ia jap zotit Kurushi.

*Klodian Kurushi*: Faleminderit!

Me disa vendime të datës 18.01.2023, Këshilli i Lartë Gjyqësor hapi katërmëdhjetë procedura të lëvizjeve paralele në gjykatat e shkallës së parë, ndër to,

65

me vendimin nr. 13, procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile.

Afati i kandidimit për këto procedura të lëvizjes paralele u përcaktua deri më datë 01.02.2023.

Brenda afatit të kandidimit për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me vendimin e përmendur më lart kandiduan gjithsej 8 (tetë) kandidatë, sipas tabelës së mëposhtme: {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}.

Pas përfundimit të afatit të kandidimit për procedurat e lëvizjes paralele dhe përcaktimit nga kandidatët të interesit për tre procedurat në proces, mbështetur në pikën 9, të vendimit 13/2023, mbi propozimin e Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, me vendimin nr.77, datë 13.02.2023, Këshilli miratoi listën e kandidatëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime etike dhe profesionale për efekt të kandidimit. Në këtë listë janë përfshirë kandidatët e mëposhtëm: znj. {...}, z. {...} dhe z. {...}.

Me vendimin e datës 13.03.2023, Këshilli ka vendosur: “I. Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Rrethit gjyqësor Tiranë, të shpallura me vendimet, ndër të tjera nr. 12, nr. 13, të datës 18.01.2023.

Për të evidentuar kandidatët që përmbushnin kriteret e kandidimit të lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Këshilli realizoi procedurat e verifikimit të plotësimit nga 2 (dy) prej kandidatëve të kriterëve të mëposhtme (pasi z.{...} u tërhoq nga kandidimi i tij për pozicionet e shpallura me vendimet nr.11, nr. 12 dhe nr. 13 datë 18.01.2013).

U verifikuan kriteret e 1. “përvojës profesionale minimale”, 2. “mospasjes masë disiplinore në fuqi”, 3. “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

Kandidatët e kualifikuar sipas pozicioneve që kanë aplikuar ishin: z. {...} dhe znj. {...}.

Siç u parashtrua, krahas procedurave të verifikimit të kriterëve të kandidimit, paralelisht, për kandidatët kanë vijuar edhe procedurat e vlerësimit etik dhe profesional. Duke qenë se kandidatët përfshihen në listën e gjyqtarëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime për ta ishte e nevojshme përfundimi i vlerësimeve, konkretisht: 1) vlerësimi

me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016 ose për gjyqtarët që nuk e kanë kaluar këtë proces, vlerësim i parë do të konsiderohet vlerësimi i fundit etik dhe profesional që ka qenë në fuqi përpara Ligjit për Statusin; dhe 2) vlerësimi i 2-të, në mënyrë alternative si vlerësimi i përshpejtuar i detyruar për vitin kalendarik 2022, (nëse ata nuk janë përfshirë në programet e vlerësimit periodik të miratuara nga Këshilli (vlerësimi 3-vjeçar).

Me kualifikimin e kandidatëve në pozicionin respektiv nr. 13, Këshilli, me vendimin e datës 30.05.2023, vendosi fillimin e procedurave të përzgjedhjes të kandidatëve për lëvizje paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë edhe për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin e tij nr. nr. 13.

Më datë 30.05.2023, në rrugë elektronike, pasi u zgjodh relatori, kandidatët shprehën dakordësinë për relatorin e përzgjedhjes.

Në vijim të procedurës së përzgjedhjes në lëvizjen paralele për kandidatët në këtë pozicion ka rezultuar se: zoti {...} është tërhequr nga kandidimi për pozicionin nr. 13 dhe Këshilli me vendimin nr. 431, datë 18.07.2023 vendosi: “Përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për shkak të tërheqjes së tij nga kandidimi”.

Kandidate e vetme e mbetur në garë që ka dy vlerësime ishte zonja {...}.

Konkretisht, lidhur me vlerësimet etike dhe profesionale, për kandidaten e vetme u konstatua se: a) Sipas vendimit të Këshillit nr. 297, datë 13.07.2021, kandidatja është vlerësuar/graduuar për periudhën e vlerësimit 2013–2016, në nivelin e përgjithshëm “Shkëlqyeshëm”, duke grumbulluar në total 375 pikë; b) Sipas vendimit të Këshillit nr. 298, datë 13.07.2021, kandidatja është vlerësuar për periudhën 2019, në nivelin e përgjithshëm “Shumë mirë”, duke grumbulluar në total 371 pikë.

Vlerësimet etike dhe profesionale të kandidates janë konstatuar të jenë bërë përfundimtarë.

Mbi propozimin e relatorit të përzgjedhjes, Këshilli me vendimin e datës 18.07.2023 miratoi vendimin “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 13, duke vendosur:

“Miratimin e renditjes së kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, [...] kandidaten si më poshtë:

1. Znj. {...}.”

Vendimi iu njoftua rregullisht, më datë 18.07.2023, në rrugë elektronike, kandidates znj. {...}.

Kandidatjs znj. {...}, në rrugë elektronike, më datë 18.07.2023, konfirmoi marrjen e njoftimit për vendimin. Po ashtu, kjo candidate, në rrugë elektronike, më datë 18.07.2023, i bëri të ditur Këshillit se nuk do të ushtronte ankim.

Në kushtet kur kandidatja ka konfirmuar dakordësinë me vendimin për renditjen e Kandidatëve, të datës 18.07.2023, si dhe ka deklaruar se nuk ka ankim ndaj tij, ky vendim konsiderohet se ka marrë formë të prerë.

Për rrjedhojë, në zbatim të pikës 111, të vendimit të Këshillit nr.320/2020, relatori i procedurës së përzgjedhjes përgatiti projektvendimin për transferimin e gjyqtares znj. {...} në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 13, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në kushtet kur aktualisht, znj. {...} është e transferuar me pëlqim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, sipas vendimit të mësipërm, për një periudhë deri 1 vit, Komisioni propozon përfundimin përpara afatit të këtij transferimi me pëlqim, sipas projektvendimit bashkëlidhur këtij relacioni.

Projektvendimi është i strukturuar në tre pika.

Në pikën e parë të tij propozohet transferimi i gjyqtares znj. {...} për shkak të lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë më datë 24.07.2023, pra ditën e sotme.

Një kopje e vendimit i njoftohet kandidates. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ndërsa projekti i dytë që ka lidhje me përfundimin e afatit të transferimit të përkohshëm, përmban gjithsej 4 pika.

Pika e parë është përfundimi para afatit të transferimit të përkohshëm me pëlqim, për gjyqtaren znj. {...}.

2. Efektet e këtij vendimi fillojnë më datë 24.07.2023.

3. Një kopje e vendimit t'i njoftohet kandidatës sipas kërkesave të shkronjës "c", pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 [...].

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit z. Kurushi!

Nëse nuk kemi diskutime, kalojmë në votimin fillimisht të aktit të parë. Ilir!

**Ilir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Naureda Llagami:** Marçela!

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Naureda Llagami:** Yllka!

**Yllka Rupa:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Transferimin e gjyqtarës znj. {...} për shkak të lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

2. Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë më datë 24.07.2023.

3. Një kopje e vendimit i njoftohet znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, Gjykatës së

Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**Naureda Llagami:** Kalojmë dhe projekt-aktin e dytë që është në vijim të këtij të parit, që ka të bëjë me përfundimin para afatit të transferimit të përkohshëm me pëlqim për znj. {...}. Jemi dakord? Ilir!

**Ilir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Naureda Llagami:** Marçela!

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Përfundimin para afatit të transferimit të përkohshëm me pëlqim, për gjyqtaren znj. {...}.

2. Efektet e këtij vendimi fillojnë më datë 24.07.2023.

3. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares znj. {...} sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër (*duhet Fier*) dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Me kaq po e mbyllim mbledhjen për sot.

Faleminderit!

Punë të mbarë!

\* \* \*

(Pika 12 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**